



# KUVENDI I PUNËS

FEDERATA E BASKETBOLLIT TË  
KOSOVËS

13 MARS 2024, PRIZREN

# PËRMBAJTJA

## PJESA I: RAPORTI I AKTIVITETEVE PËR VITIN 2023

1. Grantet dhe sponsorizimet 2023
2. Përfaqësimi ndërkombëtar
3. Kampionati, Kupa dhe Superkupa
4. Klubet e Superligës në arenën ndërkombëtare
5. Liga Unike
6. Trajnime/seminar për trajnerë/gjyqtarë/vëzhgues
7. Projektet Zhvillimore
8. Organizimet e garave ndërkombëtare
9. Ngritja e kapaciteteve
10. Më të mirët e vitit 2023
11. Të tjera

## PJESA II: PLANI I VEPRIMIT PËR VITIN 2024

1. Grupet e interesit
2. Objektivat strategjike për vitin 2024
3. Garat e FBK-së
4. Klubet dhe anëtarët e saj
5. Aktivitetet e Përfaqësueseve të Kosovës
6. Aktivitetet e Basketbollit 3x3
7. Aktivitetet për trajnerë
8. Aktivitetet për gjyqtarë/vëzhgues
9. Projektet zhvillimore
10. Ngritja e kapaciteteve njerëzore
11. Zhvillimi i diplomacisë sportive
12. Organizimi i eventeve dhe aktivitetet tjera
13. Aktet normative të FBK-së
14. Plani Financiar për vitin 2024
15. Sfidat e pritshme për 2024
16. Plani Strategjik – Implementimi

# RAPORTI I AKTIVITETEVE PËR VITIN 2023

# HYRJE

- Viti 2023 ishte shumë i ngjeshur me aktivitete për Federatën e Basketbollit të Kosovës (FBK), si në garat vendore, ashtu edhe në ato ndërkombëtare.
- Federata e Basketbollit e Kosovës gjatë vitit që po e lëmë pas ka shënuar të arritura të mëdha, por sigurisht se ne nuk do të ishim në gjendje ta bënim këtë pa angazhimin dhe mbështetjen e të gjitha grupeve tona të interesit.
- Për FBK-në ky ishte viti i tretë i implementimit të Planit Strategjik (2021-2025), plan ky nëpërmjet të cilit synon të zhvillohet dhe të rritet, andaj FBK e ka përgatitur një vizion realist për të ardhmen e Federatës nëpërmjet hartimit të këtij plani me ç 'rast ne do të përqipemi të shtyjmë potencialin tonë për zhvillim dhe për rritje të Federatës.
- Ka ende shumë punë për të bërë përpara për të realizuar misionin dhe vizionin tonë, dhe këtë ne tashmë e dimë. Por, me krenari për atë që kemi arritur bashkërisht me grupet tona të interesit këtë vit, ne do të ballafaqohemi me të ardhmen me besim dhe optimizëm.

1.

# GRANTET DHE SPONSORIZIMET 2023

# - GRANTET DHE SPONSORËT E FBK-SË



SUPPORTED BY:

GENERAL SPONSOR

GOLDEN SPONSOR

SILVER SPONSORS

YOUTH BASKETBALL SUPPORTERS

AUTOMOTIVE SPONSOR



# - STATISTIKA RRETH SPONSORIZIMIT NË VITIN 2023



## MBËSHTETJA PËRMES SPONSORIZIMIT NË SPORT PËR VITIN 2023

	Nr i Vërtetimit	
Futboll	415	€6,008,572.00
<b>Basketboll</b>	<b>374</b>	<b>€5,844,666.02</b>
Volejboll	168	€1,080,900.00
Hendboll	117	€752,360.00
Autosporte	23	€319,300.00
Skitari	14	€221,500.00
Xhudo	7	€180,500.00
Noti	15	€131,000.00
Tenis	21	€122,660.00
Ping-Pong	29	€100,600.00
Sporte Tjera	159	€911,988.85
<b>TOTAL</b>	<b>1342</b>	<b>€15,674,044.87</b>

## 2. PËRFAQËSIMI NDËRKOMBËTAR

- Më 25 prill 2023 është hedhur shorti për Rrethin e Tretë Parakualifikues për FIBA EuroBasket 2025



- Dardanët u përcaktuan në Grupin H, së bashku me Zvicrën dhe Danimarkën



-|-

## - PËRFAQËSUESJA A

Kosova me 2 fitore e 2 humbje

- **Kosova – Zvicra 76:49**
- Danimarka – Kosova 82:75
- **Zvicra – Kosova 72:76**
- Kosova – Danimarka 63:88



# - PËRFAQËSUESET E REJA

## FIBA Kampionatet Evropiane

- Kosova U20 (M) renditet e 11-ta, Divizioni B, në Shkup, Maqedoni Veriore
- Kosova U20 (F), Divizioni B, në Craiova, Rumani
- Kosova U18 (M), Divizioni B, në Matosinhos, Portugali
- Kosova U18 (F) Divizioni C, në Durrës, Shqipëri
- Kosova U16 (M) Divizioni C, në Prishtinë, Kosovë



-|-

## - PËRFAQËSUESET 3X3

- **Kualifikimet e FIBA Europe Cup 3x3** (në të dyja konkurrencat)
- **FIBA 3x3 U23 Nations League** (në të dyja konkurrencat)
- **FIBA 3x3 Women's Series**
- **Lojërat Mesdhetare në Rërë 'Heraklion 2023'** (në të dyja konkurrencat)







3.

# KAMPIONATI, KUPA DHE SUPERKUPA E KOSOVËS



-|-

# - KAMPIONËT

## • KUPA E KOSOVËS



- KB Trepça
- KBF Bashkimi

## • SUPERLIGAT



- KB Peja
- KBF Bashkimi

## • SUPERKUPA E KOSOVËS



- KB Trepça
- KBF Bashkimi

## • Kupa e veteranëve – KB Vëllaznimi



## - KAMPIONËT – KATEGORITË E REJA

1 >

**Superliga U18:**  
Marigona Hill  
Prishtina

4 >

**Liga U18:**  
Sigal Prishtina

7 >

**Liga U16 Vajzat:**  
KBF Prishtina

2 >

**Superliga U16:**  
Marigona Hill  
Prishtina

5 >

**Liga U16 Lindje – Perëndim:**  
Drita

8 >

**Liga U14 Vajzat:**  
Junior 06 Moni Bau

3 >

**Superliga U14:**  
Marigona Hill  
Prishtina

6 >

**Liga U14 Lindje – Perëndim:**  
Theranda Basket

9 >

**Liga U12 Lindje – Perëndim:**  
Trepça



-|-

4.

# KLUBET E SUPERLIGËS NË ARENËN NDËRKOMBËTARE

## - PEJA DHE TREPÇA

### • KB Peja

- Basketball Champions League  
Bakken vs Peja: 103:79.
- FIBA Europe Cup  
Luftoi deri në fund, por nuk arriti  
kualifikimin nga grupet  
(2 fitore, 2 humbje)



### • KB Trepça

- Për herë të parë në grupet e FIBA  
Europe Cup  
1 fitore, 3 humbje



-|

5.



**LIGA  
UNIKE**

-|-

## - KAMPIONËT

- Final 4 Liga Unike Femrat u organizua në Vlorë, ku morën pjesë 2 ekipe nga Kosova dhe 2 nga Shqipëria
  - Partizani u shpall kampion pas fitores ndaj Flamurtarit




-|-

6.

# TRAJNERËT & GJYQTARËT



# - TRAJNIMET/SEMINARET PËR TRAJNERË/GJYQTARË/VËZHgues



7.

# PROJEKTET ZHVILLIMORE



## Junior NBA

- Krasniqi më 21 janar mori pjesë në Punëtorinë e JB NBA Ligës në Paris
- Më 20 mars u hodh shorti për JR NBA Kosova



## Her World Her Rules

- FBK ka vazhduar me zbatimin e kësaj fushate mediale të FIBA Europe, ku janë organizuar aktivitete të ndryshme



## FIBA Europe Youth Development Fund (YDF)

- Kosova mori pjesë në turneun në Bullgari
- Prej 8 deri 12 qershor u mbajt turneu në Prizren



## KAMPI NACIONAL

- Nga 18 deri më 23 korrik është mbajtur Kampi Nacional. Morën pjesë fëmijët e lindur më 2010-2011, në të dyja konkurrencat. Synimi i këtij kampi është zhvillimi i gjeneratave të reja, që më vonë do të jenë pjesë e Përfaqësuesëve të Kosovës.





## PROMISE (Një Hap Përpara për Basketbollin e Vajzave dhe Grave)

FBK për herë të parë është bërë pjesë e një projekti në kuadër të programit të Erasmus+.

Objektivi i përgjithshëm i projektit është të promovojë përfshirjen dhe pjesëmarrjen e vajzave dhe grave në basketboll në të gjitha nivelet e përgjegjësive nëpërmjet hartimit, zbatimit dhe vlerësimit të një programi gjithëpërfshirës të ndërhyrjes.

Ka filluar në Janar 2023 dhe do të përfundojë në Qershor 2025.



## FBK fituese e projektit "SAFEGUARDING THE FUTURE" në Erasmus +

FBK për herë të parë është koordinatore e një projekti në kuadër të programit të Erasmus+.

Projekti synon të krijojë mekanizma në Kosovë, Estoni dhe Bullgari që sigurojnë një përvojë basketbolli të sigurt, pozitive dhe argëtuese për të gjithë njerëzit e përfshirë në basketboll, me theks të veçantë tek fëmijët dhe të rinjtë.

Ky projekt do të zgjasë 18 muaj, duke filluar nga janari 2024 deri në qershor 2025.



## Programi Shtetëror "Sport në Shkollë"

Memorandum i Bashkëpunimit për Programin "Sport në Shkollë" ndërmjet Federatës së Sportit Shkollor të Kosovës, Federatës së Basketbollit të Kosovës dhe Federatës së Shahut të Kosovës.

**Programi tashmë përfshin rreth 870 fëmijë.**

Qëllimet kryesore të programit 'Sport në Shkollë' janë:


- Inkuadrimi dhe praktikimi i sportit të basketbollit 3x3 dhe atij të shahut në shkollat publike si aktivitet ekstrakurrikular;
- Organizimi i garave;
- Promovimi i vlerave sportive dhe trajtimi i çështjeve sociale përmes sportit; dhe
- Ngritja e kapaciteteve njerëzore në fushën e edukimit dhe sportit



+ -

8.

# ORGANIZIMET E GARAVE NDËRKOMBËTARE



1

FIBA U16  
Kampionati Evropian  
– Divizioni C, 2023



2

FIBA 3x3 Prishtina  
Challenger 2023



3

FIBA 3x3  
Women's Series 2023

4

FIBA 3x3 U23  
Nations League 2023  
(stop 1 dhe stop 3)

+

9.

# NGRITJA E KAPACITETEVE

Drejtori Teknik mori pjesë në Konventën e Mini Basketbollit në Madrid

Menaxheri për Media përfundon me sukses FIBA Programin "Eurostep"

Drejtori Teknik merr pjesë në Seminarin për Shëndetin Mental

Këshilltarja Ligjore për Sport pjesë e FIBA Foundation European Youth Leadership Program

Menaxherja e Financave dhe Asistentja Ekzekutive diplomojnë me sukses në Programin WiLEAD

Zyrtarja për Integritet mori pjesë në Punëtorinë e dytë për SPOC Personat në Athinë

Menaxherja e Eventeve pjesëmarrëse në Programin S2ABC Project për Administratën Sportive

Menaxherja e Projekteve dhe Këshilltarja Ligjore për Sport pjesë e Programit "Future Leaders in Football"







Menaxheri i Përfaqësueseve përfundon me sukses Programin FIBA Players Mentorship

-|-

# 10. MË TË MIRËT E 2023



# - FITUESIT NË SHPALLJEN E LAUREATËVE



-|-

# - CEREMONIA E LAUREATËVE 2023



©Kosovo Basketball Federac

©Kosovo Basketball Federation





-|-  
- SUPERLIGA FEMRAT - IDENTITETI



-|-

11.

TË TJERA



Kryetari i FBK-së, Arben Fetahu, zgjidhet anëtar i Bordit të FIBA Evropës

Kryetari i FBK-së zgjidhet nënkryetar i FIBA Europe Youth Commission, Sekretarja e Përgjithshme anëtare


Sekretarja e Përgjithshme ishte pjesë e panelit "Women in Leadership Forum"



Drejtori Ekzekutiv i FIBA Europe, Kamil Novak, vizitoi Kosovën

Sekretarja e Përgjithshme e përfaqësoi FBK-në në Kongresin e FIBA-s në Manila

FBK për herë të parë me përfaqësues në një Komision të FIBA Botës, Sekretarja e Përgjithshme emërohet anëtare e Komisionit të FIBA 3x3



Vlora Braha nominohet në ndeshje të FIBA EuroBasket 2025 Qualifiers

Pensionohet basketbollisti i shumë-trofeshëm Alban Veseli

Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka dekoruar me Medalje Presidenciale të Meritave legjendat e basketbollit të Kosovës, Mithat Belegu, Resmije Juniku dhe Masar Nixha.



# - SFIDAT E SHFAQURA GJATË VITIT 2023

Federata e Basketbollit e Kosovës është ballafaquar me një sërë sfidash gjatë vitit 2023, duke përfshirë:

Financat/Të hyrat nga sponsorët aktual nuk janë realizuar sipas planit financiar, kurse edhe sponsorë të rinj nuk kemi arritur të sigurojmë, jo në masën siç kemi planifikuar.

Rekrutimi dhe zhvillimi i lojtarëve/eve të reja/Mungojnë prurjet e reja nga klubet.

Mungesa e rezultateve me Përfaqësuese në arenën ndërkombëtare (dy konkurrencat dhe të gjitha kategoritë).

Prezenca jo e mjaftueshme në media e sportit të basketbollit

Mungesa e Infrastrukturës/Vazhdon të jetë problem për zhvillimin e mirëfilltë të basketbollit në vend.

Mbrojtja e integritetit të lojës/Rasti i gjyqtarit Daut Mehmeti dhe disa raste të tjera ku është tentuar të keqpërdoret sporti, në këtë rast basketbolli.

Dhuna në palestra nga ana e tifozëve gjatë zhvillimit të ndeshjeve të basketbollit ka qenë imazh shumë i keq për basketbollin e Kosovës.

Promovimi i sportit për të rritur interesin publik tek të rinjtë/rejat për të praktikuar basketbollin.

Komunikimi FBK-Klube/Është i kënaqshëm, por duhet punuar edhe më shumë së bashku në këtë drejtim.

Kriteret për Licencim të Klubeve/Për dallim të dy viteve të para në vitin 2023 klubet kanë qenë më serioze në plotësimin e kriterëve, por që gjithsesi FBK duhet të punojë së bashku me klube edhe në këtë drejtim në mënyrë që për çdo vit klubet të fuqizohen duke zbatuar kriteret.


-|-

12.

RAPORTI I AUDITIMIT  
TË PASQYRAVE FINANCIARE  
TË VITI 2023

## - TË HYRAT E FBK-së


- Gjatë vitit **2023**, në krahasim me vitin 2022, të hyrat e FBK-së u rritën për **61%**, ku gjatë vitit **2022** kishim total 1,338,618 Euro, kurse gjatë vitit 2023 total **2,152,416 Euro**, apo një rritje prej 813,798 Euro.



-|-

## - TË HYRAT E FBK-së

- Pjesëmarrja e të hyrave sipas kategorive në të hyrat totale qëndron në këtë formë:



## - TË HYRAT E FBK-së

191% ↑

Të hyrat nga MKRS u rriten 191%, ku gjatë vitit 2023 si rezultat i projekteve të veçanta me MKRS përfituam 745,307 Euro më shumë se në vitin 2022.

6% ↓

Nga sponsorizimet patëm një rënie prej 6%, ku gjatë viti 2023 përfituam nga Ligji për Sponsorizim 33,370 Euro më pak se sa në vitin 2022.

22% ↑

Për të hyrat nga aktivitetet e FBK-së, (anëtarësimet e klubeve, licencimet, vendimet e informatorëve, të hyrat nga partnerët e huaj, të hyrat nga organizimet ndërkombëtare etj.) rritje në vlerë prej 65,043 Euro.

€53,497

Gjatë vitit 2023, FBK fitoi dy projekte me Erasmus +, Projekti PROMISE dhe Projekti Safeguarding the Future

€192,063

FBK përbyll vitin 2023 me një suficit në pasqyrat financiare prej 192,063 Euro, ku vitin 2022 e përbyllëm me një deficit prej 37,441.



## - Shpenzimet e FBK-së

↑ 42%

Shpenzimet totale:  
1,960,353 EUR

- Shpenzimet me pjesëmarrje më të lartë

16.89%

Shpenzimet e udhëtimit dhe akomodimit për të gjitha Përfaqësueset e Kosovës, Qendra Nacionale, Liga Unike, YDF, organizimet e eventeve ndërkombëtare 5x5 dhe 3x3, etj.

12.14%

Pagat e personave zyrtarë të ndeshjeve  
Rritje prej 62% nga viti 2022, apo në vlerë prej 90,726.00 Euro, si rezultat i rritjes së taksave për persona zyrtarë të ndeshjeve me vendim të Bordit të FBK-së.

13.02%

Paga dhe mëditje për pjesën tjetër të pagesave ndaj personave fizik të angazhuar për të kryer shërbime ndaj FBK-së ka

10%

Pagat e stafit të FBK-së

9.73%

Shpenzimet për LED Reklamat, Rekuizitat Sportive dhe Brendim

-|-

## - Detyrimet e FBK-së

- FBK përmbyll vitin me detyrime afatshkurta në vlerë prej 352,046 Euro, 80,542 Euro më shumë se vitin 2022, apo 29%. Prej këtyre 61,632 Euro ndaj furnitorëve, 60,000 Euro parapagime nga sponsorët, 51,511 Euro ndaj personave fizik, 42,162 Euro detyrime tjera, 136,740 ndaj ATK-së.

# PLANI I VEPRIMIT PËR VITIN 2024 CKA NA PRET NË 2024?



## - 2. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE PËR VITIN 2024

Zhvillimi dhe fuqizimi i klubeve anëtare të FBK-së nëpërmjet programeve të qeverisjes së mirë;

Masivizimi i basketbollit 3x3 në shkolla dhe basketbollit 3x3 elitar;

Rritja e të hyrave në FBK;

Zvogëlimi i deficitit financiar;

Fillimi i zbatimit të projektit “Safeguarding the Future”

Fuqizimi i projekteve FIBA Europe Youth Development Fund, FIBA Europe Girls Program, Jr. NBA, Mini-Basketbollit;

Integriteti në Sport;

Rritja e numrit të refereve femra;

Vazhdimi i edukimit të trajnerëve/eve të basketbollit në Kosovë;

Rritja e numrit të administratoreve femra;

Organizimi dhe bashkë-organizimi i 5 eventeve të FIBA dhe FIBA 3x3 në nivelin e kërkuar;

Promovimi i Kosova U16 Meshkujt në Divizionin B;

Identifikimi i lojtarëve/e vendor/e nga jashtë vendi – potencial për Përfaqësueset e Kosovës në të dyja konkurrencat;

Fuqizimi i imazhit të Përfaqësueseve në të dyja konkurrencat;

Investimi në burimet njerëzore të FBK-së;

Vazhdimi i projektit të Ligës Unike në të dyja konkurrencat;

Zhvillimi i mëtutjeshëm i brendit/markës të Federatës së Basketbollit të Kosovës;

Rritja e numrit të projekteve të fituara në Erasmus+ dhe organizimi i projekteve të përbashkëta me Ambasadat e huaja e organizata të tjera në Kosovë për promovimin e vlerave të përbashkëta.

## - 3. GARAT E FBK-së

Kategoritë e reja  
(dy konkurrencat);

1

Kategoria senior  
(dy konkurrencat);

2

3

Final 8 Kupa e Kosovës (dy  
konkurrencat);

Superkupa e Kosovës (dy  
konkurrencat);

4

5

Garat e  
veteranëve/eve;

Bashkë-organizimi i garave në Ligën  
UNIKE (dy konkurrencat).

6

## - 4. KLUBET DHE ANËTARËT E SAJ

Fuqizimi i kriterëve për licencim të klubeve;

Organizimi i seminareve për klubet (Qeverisje të Mirë/Përgjegjësia, Llogaridhënia, Ndërgjegjësimi, Paanshmëria, Transparenca; Integriteti në Sport, Edukimi për Anti-doping, Menaxhim Sportiv etj.);

Garat ndërkombëtare;

Shpërblimet;

Donacionet (veshmbathje sportive, topa, etj.);

Fuqizimi i bashkëpunimit/komunikimit me klubet;

Organizimi i takimeve në mes klubeve dhe krerëve të FBK-së (para fillimit të edicionit, gjatë edicionit dhe pas përfundimit të edicionit).

## - 5. AKTIVITETET E PËRFAQËSUESEVE TË KOSOVËS

01

Kosova A në para-kualifikimet evropiane për FIBA Kupën e Botës;

02

Kosova A Femrat në FIBA Kampionatin Evropian të Shteteve të Vogla;

03


Përfaqësueset e Reja në FIBA Kampionate Evropiane: U16, U18 dhe U20 në konkurrencën e meshkujve dhe U16 dhe U18 në konkurrencën e femrave;

04

Seminaret për anti-doping për basketbollistët/basketbollistet dhe shtabin teknik të Përfaqësueseve;



## - 6. AKTIVITETET E BASKETBOLLIT 3X3



## - 7. AKTIVITETET PËR TRAJNERËT

1

Edukime për trajnerët në bashkëpunim me FIBA-n;

Pjesëmarrja në FIBA Konventën e Mini-Basketbollit;

4

7

Pjesëmarrja në FIBA U14 Get Together;

Edukime për trajnerët e Mini-Basketbollit;

2

5

Pjesëmarrja në FIBA U14 Get Together;

Përgatitja e Nivelit 2

8

3

Seminare/klinika para-sezonale;

Pjesëmarrja në programin për trajnerë të FIBA-s, FECC;

6

# - 8. AKTIVITETET PËR GJYQTARË/VËZHgues

1

FIBA SCOD Klinika para-sezonale;

Klinika për FIBA Referee Instructor;

5

9

Klinika për Statistika;

FIBA PRNC Klinika;

2

6

Gjyqtarët kosovarë në FIBA Kampionate Evropiane të gjeneratave të reja;

FIBA FRIP Level 1;

10

3

FIBA SCOD Kampi;

Kampi Veror për gjyqtarë;

7

11

Nominimi i Technical në ndeshje ndërkombëtare;

Play-Off Klinika;

4

8

SCOD seminari për gjyqtarë dhe vëzhgues;

Vazhdimi i punës me referët/delegatët e rinj.

1

2

## - 9. PROJEKTET ZHVILLIMORE

3x3 në shkolla/Programi  
'Sport në Shkolla'

FIBA Europe Youth  
Development Fund (YDF  
Europe)

FIBA Europe Girls  
Program (kampanja Her  
World, Her Rules)

Minibasketbolli

Promise (Erasmus+)

Safeguarding the  
Future (Erasmus+)

Jr. NBA Kosova

Kampi Nacional i FBK-së

Kampi në Postojna

Edukimi dhe zhvillimi i stafit të zyrës ekzekutive në programet e FIBA-s, KOK-ut, KON-it, UEFA/FIFA etj.;

## 10. NGRITJA E KAPACITETEVE NJERËZORE

Përfaqësimi i FBK-së në konferenca të ndryshme brenda dhe jashtë vendit.

# - 11. ZHVILLIMI I DIPLOMACISË SPORTIVE



Pjesëmarrja e Kryetarit të FBK-së në mbledhjet e Bordit të FIBA Evropës në cilësinë e anëtarit të Bordit;

Pjesëmarrja e Kryetarit dhe Sekretares së Përgjithshme në takimet e punës të FIBA Europe Youth Commission;

Pjesëmarrja në Asamblenë e Përgjithshme të FIBA Europe;

Pjesëmarrja në Takimin Vjetor të Sekretarëve të Përgjithshëm të FIBA Evropës;

Pjesëmarrja në shortin e Përfaqësueseve të Reja;

Pjesëmarrja në aktivitetet e Përfaqësuesve të Reja;

Pjesëmarrja në Punëtoritë e Junior NBA.

## - 12. ORGANIZIMI I EVENTEVE DHE AKTIVITETET Tjera

### Ndërkombëtare

- FIBA Kampionati Evropian për Shtete të Vogla për Femra – Senioret, në Prishtinë;
- FIBA U18 Kampionati Evropian, Divizioni C për Femra në Prishtinë;
- FIBA 3x3 Europe Cup Qualifier (dy konkurrencat) në Prishtinë;
- Bashkë-organizimi i FIBA 3x3 Women's Series nw Prishtinë (organizator klubi 3x3 Prishtina);
- Bashkë-organizimi i FIBA 3x3 Challenger Prishtina në Prishtinë (organizator klubi 3x3 Prishtina);

### Vendore/të tjera

- Kuvendi i Punës të FBK-së;
- Kuvendi Zgjedhor i FBK-së;
- Organizimi i aktiviteteve të përbashkëta me partnerët/sponsorët e FBK-së;
- Pjesëmarrja me veteranët/et në aktivitete jashtë vendit.


## - 13. AKTET NORMATIVE TË FBK-së

### Miratimi i akteve normative për edicionin e ardhshëm garues:


- Rregullorja e Përfaqësueseve të Kosovës
- Propozicionet e Garave për Kategoritë Seniore, Edicioni 2024/25
- Propozicionet e Garave të Ligave të Kategorive të Reja, Edicioni 2024/25
- Rregullorja për Regjistrim dhe Kalim në FBK, Edicioni 2024/25
- Rregullorja për Licencim dhe Garim në FBK, Edicioni 2024/25
- Propozicionet e Garave të Kupës së Kosovës
- Udhëzues për Organizimin e Final 8 Kupës së Kosovës
- Udhëzues për Organizimin e Superkupës së Kosovës
- Propozicionet e Garave për Kategorinë e Veteranëve, Edicioni 2024/25
- Përditësimi dhe miratimi i akteve tjera normative sipas nevojës.



# - 14. PLANI FINANCIAR 2024



# - 14. TË HYRAT PËR VITIN 2024



## - 15. SFIDAT E PRITSHME PËR VITIN 2024

Në vitin 2024, FBK mund të përballet me një sërë sfidash të ndryshme, duke përfshirë:

Menaxhimi i burimeve financiare/Financimi është gjithmonë një sfidë për Federatën e Basketbollit të Kosovës.

Marketingu dhe sponsorizimi/FBK duhet të jetë në gjendje të sigurojë sponsorë të mjaftueshëm dhe të ndërmarr fushata të suksesshme marketingu për të rritur ndikimin në publik dhe të sigurojë mbështetje të nevojshme financiare.

Konkurrenca ndërkombëtare/Përfaqësueset e Kosovës, dy konkurrencat, të gjitha kategoritë mund të përballen me një konkurrencë të fortë në gara ndërkombëtare.

Zhvillimi i talentit/Gjetja, zhvillimi dhe mbajtja e talentëve të reja në basketboll është gjithmonë një sfidë për FBK-në. FBK dhe klubet e saj duhet të investojnë në strukturat bazë nëpërmjet programeve aktuale dhe atyre që pritet të vijnë si në nivel të Qeverisë, FBK-së dhe klubeve.

# - 16. PLANI STRATEGJIK - IMPLEMENTIMI

## VIZIONI

**Ta avancojmë basketbollin në Kosovë për tu bërë histori sukcesi në të gjitha nivelet.**

*Kjo nënkupton:*

*Të kemi 4000 lojtarë të regjistruar deri më 31 dhjetor 2025*

*Të kualifikohemi në një turne të FIBA-s (meshkujt ose femrat) deri më 31 dhjetor 2025*

*Të bëhemi sporti më i dashur në Kosovë*

*Të kemi stabilitet financiar dhe të shtojmë burimet e të ardhurave*

## MISIONI

**Ta qeverisim, zhvillojmë dhe rrisim sportin e basketbollit në Kosovë.**

## VLERAT

**Vlerat e Federatës së Basketbollit të Kosovës janë:**

**VIZIONI** - Jemi vizionarë, kreativë, kemi ëndrra të mëdha dhe gjithmonë mendojmë se si ta bëjmë basketbollin në vendin tonë më tërheqës për të gjithë pjesëmarrësit dhe grupet e interesit;

**PASIONI** - Jemi të apasionuar pas basketbollit, komunitetit dhe vendit tonë;


**FITORJA** - Jemi fitues dhe përpiqemi të promovojmë dhe zhvillojmë mentalitet të fituesit tek lojtarët, zyrtarët, grupet e interesit dhe partnerët tanë;

**RESPEKTI** - Respektojmë shumëllojshmërinë dhe lirinë e mendimit dhe gjithmonë udhëhiqemi nga parimet e gjithëpërfshirjes, transparencës dhe përgjegjësisë;

**ZELLI** - Punojmë me zell dhe angazhohemi për ta përmbushur misionin dhe vizionin tonë, duke besuar se asgjë nuk e zëvendëson punën e zellshme;



## - AKTET NORMATIVE TË FBK-së 2021-2025



### PRAKTIKAT E KRIJUARA:

FBK tashmë ka krijuar praktikën e ri-shikimit apo përditësimit të akteve përkitazi rrethanave, sugjerimeve apo në përpjekje të qartësoj/rregulloj probleme që janë shfaqur në të kaluarën.

### PARIMI I TRANSPARENCËS:


Të gjitha aktet normative janë të publikuara në ueb-faqen e FBK-së (vegëza 'Dokumentet') dhe janë të qasshme për të gjithë!

### PËRFUNDIM:

Gjatë periudhës 2021-2023, FBK jo vetëm që ka punuar drejt adaptimit dhe përditësimit të akteve të saja normative, por edhe ka plotësuar hapësirat duke miratuar Rregullore/akte normative që janë parë të nevojshme për administrim dhe funksionim më të mirë

# - KOMUNIKIMI DHE MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN

**Nr. i ndeshjeve të transmetuara (edicioni 2022/2023):**



**FBK ofron të gjitha informatat për Grupet e Interesit, si:**

paralajmërimet,  
lajmet,  
statistikat,  
foto, video e dizajne  
informatore, dhe  
buletinin informativ.

**Bashkëpunim i ngushtë me mediat vendore, e kjo sigurisht ndihmon që të ketë një vlerësim pozitiv të publiku dhe që mediat janë gjithmonë pranë garave.**

**Kompanitë e kontraktuara:** Base Agency, Shigi Studio, PIPOS

# - MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN DHE GRUPET E INTERESIT

## • Kampanjat e ndryshme/fushata bamirësi



- Vrapo Babadimër
- Vizita në qendrat e fëmijëve
- 16 ditë aktivizëm kundër dhunës me baza gjinore
- Race for the Cure
- Kampanja me klubet rreth Anti-doping
- Her World Her Rules
- SOS Fshati
- S'ka vend për dhunë në basketboll!
- Ndashje miqësore me OJQ 'Autizmi'
- Kampanjë sensibilizuese për Fibrozën Cistike



**S'KA VEND PËR DHUNË  
NË BASKETBOLL**



# - STAFI I ZYRËS EKZEKUTIVE TË FBK-SË






## - GJYQTARËT Periudha 2018-2023

	2018	2023
Numri total i gjyqtarëve të regjistruar	52	72


	2018	2023
FIBA Gjyqtarë	3	5
Vëzhgues	23	47
FIBA Commissioner	1	1
FIBA Technical Delegate	0	1
FIBA National Referee Instructor	1	1
Gjyqtarë të licencuar FIBA për punë në tavolinën zyrtare	14	21

# - GARAT E FBK-SË (2018 dhe 2023)

## KATEGORITË SENIORE



## KATEGORITË E REJA



# - DISA NGA SUKSESET KRYESORE TË PËRFAQËSUESEVE TË KOSOVËS

## KOSOVA A Meshkujt

Paraqitja në fazën kualifikuese për FIBA Kampionatin Botëror fazë e cila është zhvilluar gjatë viteve 2017/2018 ku në grup Kosova është përballur me shtete të forta si Lituania, Polonia dhe Hungaria.

## KOSOVA U20 Meshkujt

Në vitin 2023 “Dardanët” e rinj u renditën në vendin e 11-të duke shënuar rezultatin më të mirë në histori të kësaj gjenerate. Duhet theksuar fitorja mbresëlënëse ndaj Përfaqësueses së Latvisë me rezultat 81:77.

## KOSOVA U18 Meshkujt


Në vitin 2018 duke arritur që ta fitoj FIBA Kampionatin U-18, Divizioni C duke e mposhtur Qipron me rezultat 73:64 dhe kështu duke kaluar në divizionin B të kësaj gare. Si sukses tjetër i kësaj gjenerate konsiderohet triumfi në FIBA U-18 European Challenger i mbajtur në Shqipëri në vitin 2021.

## KOSOVA U16 Meshkujt

Suksesi më i madh i kësaj Përfaqësuese është triumfi në FIBA U-16 European Challenger i cili është mbajtur në Prishtinë në vitin 2021 dhe Kosova nga pesë ndeshje i ka fituar të gjitha.



# - HISTORIKU I ORGANIZIMIT TË GARAVE NDËRKOMBËTARE



# 2021-2025 SYNIMET

	31 Dec 2021		31 Dec 2022		31 Dec 2023		31 Dec 2024	31 Dec 2025
	Synimi:	Arritjet:	Synimi:	Arritjet:	Synimi:	Arritjet:	Synimi:	Synimi:
Të hyrat e gjithmbarshme	800k	1,232,606EUR	850k	1,338,618EUR	900k	2,152,417EUR	950k	1 million
Të hyrat nga sektori publik	350k	338,375EUR	360k	389,840EUR	370k	1,135,147EUR	385k	385k
Numri i trajnerëve të kualifikuar	5	4	10	14	15	28	15	20
Numri i trajnereve të kualifikuara	2	0	3	0	5	2	7	10
Numri i gjyqtarëve të kualifikuar	4	5	5	3	5	5	6	8
Gjithsej numri i pjesëmarrësve	2000	2445	2500	2004	3000	2158	3500	4000
Numri i basketbollistëve pjesëmarrës (meshkuj)	1500	2072	1700	1461	1900	1654	2300	2600
Numri i basketbollisteve pjesëmarrëse (femra)	500	373	700	543	900	505	1100	1400
Numri i basketbollistëve pjesëmarrës (gjeneratat e reja)	1000	1051	1100	1423	1200	1655	1400	1600
Numri i klubeve	125	111	130	140	135	151	140	145
Numri i klubeve me struktura të grupmoshave të reja	20	21	25	23	30	27	35	40
Numri i shkollave që bashkëpunojnë me Federatën	20	/	25	/	30	14	40	50
Mesatarja e artikujve pozitive në muaj	10	10	12	15	14	25	16	18

FALEMINDERIT PËR VËMENDJE!

